



БЛУПРИНТ ГРУПА
за реформи во правосудството

DREJTËSI PENALE EFIKASE: PASQYRË E LËNDËVE TË INICIUARA NGA PSP

SHKUP, 2020



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПСШЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

DREJTËSI PENALE EFIKASE:
PASQYRË E LËNDËVE TË
INICIUARA NGA PSP

Botues:

Koalicioni i shoqatave të qytetarëve Të gjithë për gjykim të drejtë - Shkup

Rreth botuesit:

Natali Petrovska – drejtoreshë ekzekutive Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë

Redaktor:

Ivana Petkovska

Autorë:

Natali Petrovska – *Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë*

Sibel Amet – *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë*

Zharko Haxhi-Zafirov – *Qendra për Hulumtime Juridike dhe Analiza*

Përkthim:

Vjosa Taipi

Dizajni grafik:

Daniell Mitkovski

Shtypi:

Grafohartija

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.963(497.711)(047.31)

343.1:347.963(047.31)

PETROVSKA, Natali

Drejtësi penale efikase : pasqyrë e lëndëve të iniciura nga PSP /

[autorë Natali Petrovska, Sibel Amet, Zharko Haxhi-Zafirov]. - Shkup :

Koalicioni i shoqatave të qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë",

2020. - 32 str. : ilustr. ; 25 cm

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Анекс I

ISBN 978-608-4552-47-5

1. Amet, Sibel [автор] 2. Haxhi-Zafirov, Zharko [автор]

а) Специјално јавно обвинителство (Скопје) - Предмети - Истражувања б)

Кривична постапка - Предмети на СЈО - Истражувања

COBISS.MK-ID 112443402

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe grantuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni

Përmbajtja

SHËNIME HYRËSE	1
Qëllim dhe lëndë e analizës.....	1
Metodologjia e përdorur	2
Struktura e analizës.....	2
KONSTATIME NGA ANALIZA	4
Pjesa 1: Pasqyrë e procedurave gjyqësore.....	4
1.1. Shpërndarja e lëndëve	4
1.2. Dinamika e punës së lëndëve gjyqësore	8
1.3. Shkaqe për prolongimin e seancave gjyqësore.....	14
1.4. Vetia e personave të akuzuar në procedurat.....	20
Pjesa 2: Ndryshime të Kodit penal dhe efektet mbi lëndët e PSP-së	21
2.1. Çfarë sollën ndryshimet? -Analiza e kornizës ligjore.....	21
KONKLUZA DHE REKOMANDIME	25
ANEKS I	26

SHËNIME HYRËSE

Qëllim dhe lëndë e analizës

Kriza e thellë politike që u krijua në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e shoqëruar me mos funksionim të vazhdueshëm të Prokurorisë Publike të rregullt, por edhe ndikimet politike të imponuara mbi të, ishin shkak kryesor që në vitin 2015 të formohet ad hok trup i veçantë i cili do të ketë rolin të sanojë “dëmin” e deritanishëm nga mos ndëshkimi shumë vjeçar, i politikës dhe praktikës së pranuar përgjithësisht dhe në veçanti të elitave të larta politike dhe funksionarëve në shtet. Pas ngjarjeve në Prokurorinë Speciale Publike, në gusht të vitit 2019, të cilat kulmuan me arrestimin e Prokurorit Special Publik dhe ngritjen e akuzës për kryerjen e dy veprave penale – pranimin e shpërblimit për ndikim kundër ligjor dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimeve, PSP-ja de facto nuk ekziston më, ndërsa kompetencat iu “transferuan” Prokurorisë Publike të rregullt. Duke u nisur nga relevanca e problemit, i cili është çështje qendrore e kësaj analize – efikasiteti i veprave penale, shtohet pyetja për kapacitetin e gjykatës për të udhëhequr me këtë procedura, përkatësisht çfarë është ajo që lë përshtypje për publikun, profesionistët dhe laikët, se drejtësia nuk është plotësuar.

Vazhdimi i angazhimit të vet për mbikëqyrje dhe pjesëmarrje në zbatimin e reformave cilësore, inkluzive dhe transparente, organizatat qytetare të cilat punojnë në fushën e jurisprudencës dhe janë pjesë e Bluprint grupit për reforma në jurisprudencë e bënë këtë analizë e cila përfshin dinamikën e proceseve të PSP-së, në Gjykatën penale Shkup, me vështrim mbi kapacitetet e gjykatës dhe Prokurorisë publike, njëkohësisht duke analizuar ndryshimet ligjore në Kodin penal të cilat kanë efekt potencial mbi pjesën e lëndëve të cilat u iniciuan nga PSP-ja.

Bluprint grupin për monitorimin e reformave në jurisprudencë e përbëjnë Instituti për të Drejtat e Njeriut, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Instituti për Politika Evropiane, Qendra për Hulumtime Juridike dhe Analiza dhe Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

Qëllimi kryesor hulumtues i këtij dokumenti është të analizojë mënyrën e mbajtjes së procedurave të iniciuara nga PSP-ja, nëpërmjet së cilës do të fitohet një pasqyrë e qartë për mënyrën e mbajtjes së këtyre procedurave në Gjykatën Penale Themelore, duke identifikuar mangësitë gjatë veprimit të gjykatës dhe Prokurorisë publike dhe rreziqet për shkeljen e parimit të sundimit të së drejtës me rrënjosjen e konceptit të pa ndëshkueshme risë së korrupsionit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kjo analizë është përpiluar në kuadër të vazhdimit të aksionit të përbashkët për monitorimin e reformave në jurisprudencë, nga Bluprint grupi me titull “Për drejtësi – Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për reforma në jurisprudencë 2019 – 2020” i realizuar me mbështetjen e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

Ky aksion i përbashkët rezultoi nga nevoja për vazhdimin e përpjekjeve për zbatim transparent, në kohë dhe llogaridhënës të reformave në sektorin e drejtësisë. Qëllimi i përgjithshëm i aksionit është rritja e pjesëmarrjes dhe ndikimi i organizatave qytetare në procesin e zbatimit të Strategjisë për reforma në gjyqësor (2017 – 2022) dhe përforcimi i pavarësisë dhe pa anshmërisë së gjyqësorit në veçanti me vlerësimin e respektimit të kornizës kohore të përcaktuar me Planin aksionar, transparencën e procesi, transparencën dhe inkluzionin, vlerësimin e cilësisë së ligjeve të propozuara dhe politikave, dhe shkallën e realizimit të qëllimeve për shkak të të cilave janë miratuar dhe ndikimi i procesit të reformave mbi gjyqësorin nëpërmjet përpilimit dhe dorëzimit të rekomandimeve bazuar në dëshmi për ligjet e propozuara dhe politikat për avancimin e debatit publik.

Metodologjia e përdorur

Fushat të cilat janë lëndë e kësaj analize janë procedurat gjyqësore të iniciuara nga PSP-ja përkatësisht pasqyrë e shpërndarjes së lëndëve, dinamika e punës në lëndët gjyqësore, shkaqet për prolongimin e seancave gjyqësore, vetia e personave të akuzuar gjatë procedurave dhe ndryshimet në Kodin penal dhe efekti mbi lëndët e PSP-së.

Metodologjia me të cilën janë grumbulluar të dhënat për përpilimin e analizës, përfshijnë pasqyrë të dokumentacionit dhe të dhëna statistikore, përkatësisht analizë të dokumenteve të qasshme nga procedurat gjyqësore të cilat ishin iniciuar si rezultat i incizimeve nga përgjimet joligjore, pasqyrë e Strategjisë për reformën në sektorin gjyqësor 2017 – 2020 me Plan veprim, Pani 18, Regjistri i vetëm kombëtar elektronik i rregullave (<https://ener.gov.mk>), institucione relevante (Ministria e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata penale Shkup, Ministria e Financave).

Për grumbullimin e të dhënave, përdoret edhe metoda e monitorimit të drejtpërdrejtë të procedurave gjyqësore në Gjykatën penale. Për përpunimin e të dhënave të grumbulluara, u realizua analizë kualitative, kuantitative dhe normative.

Struktura e analizës

Analiza fillon me shënime hyrëse, ku janë përmbledhur qëllimet dhe lënda e analizës dhe metodologjia e përdorur për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave. Pas

shënimeve hyrëse, analiza vazhdon me esencën dhe konstatimet e analizës. **Pjesa e parë**, i kushtohet procedurave gjyqësore të iniciuara nga PSP-ja. Në **pjesën e dytë**, janë analizuar ndryshimet e miratuara të Kodit penal dhe efekti i tyre potencial mbi procedurat e PSP-së.

Dokumenti përfundon me përmbledhjen e konkluzave dhe rekomandimeve të cilat rezultojnë nga analiza e kryer.

Në Aneksin e kësaj analize, ka paraqitje grafike të dinamikës së lëvizjes së lëndëve dhe kjo, konkretisht për ato lëndë të cilat sipas përbërjes së këshillit, intensitetit dhe vëllimit të materialit dëshmues dhe ngjashëm, ndoshta janë lëndët më problematike, ndërsa njëkohësisht janë evidentuar edhe si lëndë në të cilat gjykimet zakonisht janë prolonguar.

KONSTATIME NGA ANALIZA

Pjesa 1: Pasqyrë e procedurave gjyqësore

1.1. Shpërndarja e lëndëve

Sistemi kompjuterik i automatizuar për menaxhim me lëndët gjyqësore, i cili paraqet sistem të integruar kompjuterik, në të cilin regjistrohen të gjitha veprimet gjyqësore është instaluar në vitin 2009, ndërsa në bazë të tij, përkatësisht sipas programit me të cilin ai punon, kryhen punët në të gjitha gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në pajtim me nenin 174 të Rregullores gjyqësore, shpërndarja automatike e lëndëve në gjykatë, kryhet nëpërmjet sistemit të kompjuterizuar të automatizuar me lëndët gjyqësore në atë mënyrë me çka sigurohet çdo gjykatës në gjykatë, gjatë punës të ketë numër të barabartë të lëndëve sipas kriterëve të përkufizuara nga Trupi i punës për Standardizim në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë. Kryetarët e gjykatave në RMV, përcaktojnë cilat kriterë në sistemin e automatizuar kompjuterik për menaxhim me lëndët gjyqësore përdoren, gjatë shpërndarjes së automatizuar të lëndëve në çdo njësi. Ajo që është me rëndësi të madhe në drejtim të punës efektive dhe të drejtë, përkatësisht përcaktimin minimal të kapaciteteve të gjykatësve është fakti, që kryetari i gjykatës është përgjegjës për shpërndarjen e barabartë të lëndëve te gjykatësit.

Gjatë procesit të shpërndarjes së lëndëve, duke pasur parasysh se sistemi është i automatizuar, në situata të jashtëzakonshme lejohet përzjerja e faktorit njeri, që të zbatohet në mënyrë përkatëse shpërndarja e lëndëve. Kështu, nëse shkaktohet situatë, gjykatës i caktuar të përjashtohet nga pranimi i lëndëve të reja përkatësisht nga shpërndarja automatike e lëndëve, kryetari i gjykatës miraton vendim i cili përmban urdhër për përjashtim, ndërsa në të janë shënuar edhe shkaqet për përjashtimin, pas çka ai gjykatës eliminohet nga gjykatësit potencialë, të cilët do të caktohen për lëndë konkrete. Në situatë tjetër (neni 179 i Rregullores gjyqësore), kur gjykatësi nuk punon më me lloj të caktuar të lëndëve (i shkarkuar, i sistemuar në njësi tjetër, në lloj tjetër të lëndëve, mungon më gjatë nga puna etj.), kryetari i gjykatës miraton ndryshimin dhe plotësimin e Orarit vjetor për punën e gjykatës. Orari vjetor për punën e gjykatësve, përkatësisht për shpërndarjen e tyre, miratohet nga kryetari i gjykatës më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm. Në këtë mënyrë, përcaktohet orari vjetor për punën e gjykatës, ndërsa pas mendimit i cili është siguruar paraprakisht në mbledhje të gjykatësve, përkatësisht në seancën e Përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me ligjin. Ri shpërndarja, nga ana tjetër, e lëndëve të cilat i ka punuar gjykatës i cili nuk punon më, mund të kryhet me shpërndarjen e


lëndëve të gjykatës i caktuar (zakonisht ai është gjykatës i ri i zgjedhur ose gjykatës në atë njësi) ose nëse nuk është përcaktuar gjykatës, nëpërmjet shpërndarjes automatike të të gjitha lëndëve të gjykatësit, të të gjithë gjykatësit e njësisë të cilët punojnë me të lloj të lëndëve.

Shpërndarja e automatizuar e lëndëve (neni 181) realizohet nëpërmjet tre modeleve të parashikuara kur bëhet fjalë për gjykatës të ri të zgjedhur ose gjykatës të sistematizuar në vend të ri, ndërsa kryetari i gjykatës është ai i cili vendos në lidhje me atë se cili model do të zbatohet në rastin konkret. Modeli i parë nënkupton shpërndarjen e të gjitha lëndëve të gjykatës i caktuar (zakonisht i ri i zgjedhur ose i sistematizuar në atë njësi, ose sipas llojit të lëndës), i cili fiton punë të gjitha lëndët e reja të pa arkivuar nga gjykatës tjetër (të pa zgjidhura dhe të zgjidhura për të cilat procedura vazhdon). Në pajtim me modelin e parë të parashikuar, gjykatësi fiton vetëm një lëndë të re të formuar nëpërmjet përfshirjes së gjykatësit në shpërndarjen e automatizuar të lëndëve me vlerë initiale, e cila paraqet përqindje (përqindja përcaktohet nga kryetari i gjykatës). Modeli i tretë, nga ana tjetër, nënkupton ri shpërndarjen e lëndëve të shpërndara të gjykatës të cilët punojnë me atë lloj të lëndëve. Gjatë kësaj, duhet të kihet parasysh se lëndët në të cilat është mbyllur diskutimi, shqyrtimi ose seanca e këshillit, si dhe lëndët që përsëri janë regjistruar, të mos shpërndahen.

Kur bëhet fjalë për lëndë të cilat janë iniciuar nga PSP-ja, ndërsa të cilat në masë të madhe gjenden në Njësinë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion pranë Gjykatës themelore penale në Shkup, duhet të përmendet fakti se ato janë iniciuar në disa data konkrete, më saktë për një pjesë të tyre janë ngritur akuza më 29.6.2017, ndërsa për një pjesë më 30.6.2017, ndërsa vetëm një akuzë është parashtruar më 5.4.2017. Pas parashtrimit të tyre në gjykatë vijoi faza e vlerësimit të akuzës, refuzimi apo aprovimi i tyre, përkatësisht hyrja në fuqi. Me përfundimin e kësaj faze, akuza transformohet në lëndë gjyqësore e cila fiton numrin e vet dhe më pas shpërndahet te gjykatës konkret në pajtim me modelet e përmendura të shpërndarjes. Duke e pasur parasysh faktin se në momentin e parashtrimit dhe aprovimit të këtyre akuzave përbërja e gjykatësve në Njësinë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion pranë Gjykatë penale ishte drastikisht më e ndryshme krahasuar me sot, lëndët pësuan ndryshime në raport me këshillat gjyqësore. Përkatësisht, në pajtim me Rregulloren gjyqësore, kryetari i gjykatës ka mundësi një herë në vit të bëjë ndryshimin e orarit të gjykatësve sipas njërive, kështu, duke mos ndërhyrë më thellë në periudhën e kaluar kohore, lënda e analizës do të jetë periudha e parashtrimit të akuzave për këto lëndë – të vitit 2017, përkatësisht ndryshimi i parë i bërë pas parashtrimit të tyre.

Duke iu referuar muajit qershor të vitit 2017 si bazë fillestare, kur në fakt edhe janë parashtruar numri më i madh i akuzave, duke mos e neglizhuar gjatë kësaj periudhën për vendimmarrje për parashtrim deri në aprovimin e akuzës, lëndët e para janë

shpërndarë te gjykatës gjatë muajit tetor / nëntor 2017. Por, me zgjedhjen e kryetarit të ri të gjykatës, në muajin nëntor 2017, dhe me vendimin e tij dy muaj më vonë të krijojë orar të ri vjetor¹ në vitin 2018, gjykatësit tani më të sistematizuar ndryshohen për shkak se një pjesë e tyre largohen nga kjo njësi. Kështu për shembull, lëndët nga dy gjykatës të cilët kanë vepruar me këto lëndë janë sistematizuar te dy gjykatës të tjerë të cilët tani më punonin në atë njësi dhe vendosin në lidhje me lëndët paraprakisht të pranuar nga PSP-së. Këto ndryshime, pa dyshim, më vonë do të konstatohet, se ndikojnë mbi kohëzgjatjen dhe cilësinë e procedurave për shkak se gjykatësit tëri, të emëruar në këto lëndë, janë gjykatës të cilët veprojnë së bashku në këshill, kur bëhet fjalë për lëndët, për të cilat duhet të vendosin në Këshillin e gjykatësve².




Sipas informacioneve të qasshme publikisht, nga raportet mujore të Gjykatës Penale themelore, Njësia për Krim të Organizuar dhe Korrupsion gjatë 5 – 6 viteve të kaluara, shënon vëllim të ndryshëm të punës. Me përjashtim në vitin 2016, kur mungojnë çfarë do të dhëna për vëllimin e punës së gjykatës, sepse ato nuk janë bërë publik në ueb faqen e tyre, përshtypje më të madhe lë informacioni që në vitin kur janë parashtruar të gjitha (njëzet) akuzat nga PSP-ja, në këtë gjykatë janë evidentuar prurje vjetore prej gjithsej 64 lëndë nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

¹ Njoftim për publikun data 12.01.2018 e qasshme në <http://www.sud.mk>

² Neni 25 LPP Në shkallë të parë gjykatat në këshillat përbëhen nga dy gjykatës dhe tre gjykatës porotë për vepra penale për të cilat në ligj përcaktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 vjet ose për dënim me burg të përjetshëm, ndërsa në këshillat e përbërë nga një gjykatës dhe dy gjykatës porotë për vepra penale për të cilat me ligj përcaktohet dënim më i butë. Për vepra penale për të cilat si dënim kryesor është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në pesë vjet, në shkallë të parë gjykon një gjykatës.

Lëndë të parashtruara



Burimi: Raporte vjetore dhe mujore të Gjykatës Penale Themelore në Shkup

Mirëpo, ajo që tërheq vëmendjen në mënyrë plotësuese, përpos vëllimit të reduktuar të punës, është edhe numri i zvogëluar i gjykatësve në këtë Njësi nga viti 2018 deri më sot. Përkatësisht, gjatë periudhës nga viti 2013 deri në vitin 2016 / 2017, numri i gjykatësve të cilët veprojnë në këtë Njësi është 12, që gjatë dy viteve të fundit ky numër të zvogëlohet në 9.

Shpërndarja e gjykatësve në njësi dhe grupimi i tyre në këshilla, kur duhet një lëndë të udhëhiqet nga këshilli i dy gjykatësve dhe tre gjykatës porotë, është segment shumë i rëndësishëm në menaxhimin me lëndët gjyqësore. Kjo është e rëndësishme sepse nëse një njësi e caktuar, për të cilën sipas sistematizimit është përcaktuar numër i caktuar i kuadrit njerëzor – gjykatës, nuk ka atë numër të nevojshëm, efikasiteti i punës së asaj njësie, drejtpërdrejtë do të reflektohet mbi punën me lëndët gjyqësore, cilësinë e procedurave dhe ngjashëm. Mungesa e gjykatësve në Gjykatën Penale Themelore në Shkup, është konstatuar edhe në raportin³ e Komisionit për Mbikëqyrjen mbi Zbatimin e Dispozitave të Rregullores Gjyqësore, gjatë mbikëqyrjes së fundit të kryer (09.03.2019), ku thuhet se sistematizimi i numrin të parashikuar të gjykatësve për këtë gjykatë është 73, për punën e pa penguar dhe optimale të gjykatës, por për momentin kjo gjykatë ka vetëm 49 gjykatës. Në mënyrë plotësuese, përpos numrin të supozuar optimal të nevojshëm për funksionimin e rregullt dhe normal të gjykatës, duhet edhe shpërndarja e tyre përkatëse dhe e saktë në kuadër të këshillave. Përkatësisht, për momentin, në Njësinë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion, veprojnë 9 gjykatës, të cilët formojnë 4 këshilla konstante dhe një këshill në të cilin gjykatësi anëtar i këshillit është me rotacion. Në kuadër të këtyre 4 këshillave, gjykatësit për gjykim kanë vëllim të ndryshëm të lëndëve të fituara nga PSP-ja. Më saktë, gjykatësit Ognen Stavrev dhe Osman Shabani kanë nga 3 lëndë, ndërsa njëkohësisht janë së bashku në këshill, gjykatësit Vladimir Tufegxhiq dhe Xhaneta Bektoviq kanë nga 2 lëndë dhe gjithashtu janë në këshill, gjykatësja Dobrilla Kacarska ka (kishte) 3 lëndë, mirëpo kolegu i saj – anëtar i këshillit në këto lëndë, nuk

³ Procesverbal nga këqyrja në Gjykatën Themelore Shkup 1 në Shkup, nr. arkivor 08-1417/2 i datës 16.04.2019 i qasshëm në <http://www.pravda.gov.mk>

është në këshill me asnjë nga gjykatësit të tjerë të cilët gjithashtu kanë lëndë të PSP-së. Më pas gjykatësit Goran Boshevski dhe Sofçe Gavrillova – Efremova, kanë vetëm nga një lëndë të PSP-së, në të cilat njëri gjykatës përputhet, ndërsa tjetir jo, anëtar i këshillit me të cilin punon. Nga ana tjetër, kemi edhe dy gjykatës të cilët aspak nuk kanë lëndë të cilat janë iniciuar nga PSP-ja. Pikërisht ky bilanc i cili është i nevojshëm të arrihet – shpërndarja e barabartë e lëndëve, në veçanti duke pasur parasysh se akuzat janë parashtruar gjatë dy ditëve të një pas njëshme, ndërsa është me rëndësi kryesore shfrytëzimi optimal i resurseve njerëzore në kuadër të kësaj Njësie, e cila deri në fund do të rezultonte me procedura të udhëhequra në mënyrë efikase dhe ekonomike. Në fakt, edhe vetë Rregullorja gjyqësore, parashikon procese konsultative në formatin e seancave të gjykatësve të udhëhequra nga kryetari i gjykatës dhe kjo me dinamikë prej të paktën një herë në muaj, ndërsa sipas nevojës edhe takime me shërbimin e gjykatës, në mënyrë që të shqyrtohet organizimi i punës së brendshme të gjykatës, orari i punës dhe ngjashëm, ndërsa në veçanti gjykata ballafaqohet me sfida si këto.

1.2. Dinamika e punës së lëndëve gjyqësore

Mënyra e veprimit dhe urgjenca gjatë lëndëve të cilat janë iniciuar në gjykatat në masë të madhe varet nga lloji dhe baza, por edhe nga rrethanat të cilat kanë të bëjnë me lëndën individuale dhe konkrete. Në Rregulloren gjyqësore është parashikuar se prioritet kanë dhe në fillim merren për punë lëndët për të cilat procedura zgjat periudhë më të gjatë kohore dhe lëndët të cilat mbi bazë të dispozitave të veçanta kanë trajtim të atillë, si dhe lëndët për të cilat kryetari i gjykatës në bazë të kërkesës së arsyetuar, ka aprovuar zgjidhjen e tyre me prioritet⁴. Kur bëhet fjalë për procedura penale, fillimisht merren për punë lëndë për të cilat personi është ndaluar ose vuan dënim ose për të cilat personi është larguar nga detyra ose përkohësisht ka ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Për veprimin në lidhje me lëndët sipas rendit të pranimit ose fillimisht të merren në punë lëndë urgjente ose me prioritet, drejtpërdrejtë kujdeset gjykatësi i cili procedon lëndën, si dhe kryetari i gjykatës.

Rregullorja gjyqësore parasheh ndalim të rreptë për caktimin e seancave gjyqësore për më tepër lëndë në të njëjtën orë (kur bëhet fjalë për gjykatës të njëjtë) përpos në rastet kur janë bashkuar më tepër lëndë për shkak të mbajtjes së një procedure të vetme. Numri i seancave gjyqësore gjatë një dite pune përcaktohet sipas kohëzgjatjes së veprimeve të caktuara zyrtare, numrit të personave të thërritur, llojit dhe numrit të dëshmitarëve dhe kompleksitetin e procedurës, gjatë çka mbahet llogari për orarin e punës së gjykatës dhe koha e palëve të shfrytëzohet në mënyrë racionale. Sido qoftë, caktimi i seancave gjyqësore në pajtim me Rregulloren gjyqësore, sipas rregullit bëhet në atë

⁴ Neni 182 Rregullorja e gjykatës


mënyrë që seancat gjyqësore do të mbaheshin çdo të dytën ditë. Rregullorja parashikon⁵ se veprimet të cilat i ndërmarrin gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësorë, ndërsa janë në lidhje me lëvizjen e lëndëve në gjykatë, ndërmerren ditën e njëjtë, ndërsa më së voni deri në fund të ditës së ardhshme të punës. Ka përjashtime nga ky rregull të cilat shkojnë në drejtim të asaj se kur bëhet fjalë për rritjen e vëllimi të punës, këto veprime mund të ndërmerren edhe jashtë këtij afat të parashikuar, përkatësisht më së voni në afat prej pesë ditë punë nga dita kur duhej të ndërmerren, por pas lejes së siguruar paraprakisht nga kryetari i gjykatës, përkatësisht nga administratori gjyqësor. Në këtë drejtim është parashikuar se edhe kryetari i gjykatës ka mundësi të paktën një herë në muaj të konvokojë takime të gjykatësve, ndërsa sipas nevojës edhe të mbajë takime me shërbimin gjyqësor në gjykatat, me qëllim kryerjen më efikase të detyrave të punës në gjykatë, sigurimi i mendimit për orarin e punës, harmonizim i punës në njësi, këshilla gjyqësore dhe sekretari të gjykatave, përmirësimi i metodave për punë, aftësim profesional dhe shumë çështje të tjera për punën e gjykatës.

Duke u nisur nga dinamika e caktimit të lëndëve të PSP-së, si dhe nga lëndët gjyqësore me profil të lartë, individuale, pa dyshim mund të konstatohet edhe proces më intensiv i punës për këto lëndë dhe përjashtim nga rregulli i caktuar për caktimin e lëndëve, përkatësisht mbajtja e seancave gjyqësore çdo të dytën ditë. Përkatësisht, pothuajse çdo herë kur bëhet fjalë për lëndë me interes të madh, në veçanti nëse ai interes përputhet me rrethana konkrete shoqërore – politike, lëndët caktohen në mënyrë intensive, ndërsa gjykatësit udhëhiqen nga tendencat për përfundimin e tyre sa më parë.

Në fazën e parë initiale të lëndëve – nga parashtrimi i akuzës (akt akuzës ose propozimit), dhe deri në aprovimin e saj, edhe pse Ligji për procedurë penale parasheh se Këshilli i cili vendos për vlerësimin, cakton seancë në afat prej 8 ditë nga pranimi i ankesës kundër akt akuzës, përkatësisht pas skadimit të afatit për parashtrimin e ankesës kundër akt akuzës, që nënkupton vendimmarrje relativisht të shpejtë me çka do të eliminohej problemi me dërgimin eventual të shkresave të akuzuarit, por kur bëhet fjalë për akuzat e PSP-së, mesatarisht kjo fazë zgjat 4 - 5 muaj. Me atë që, kur do të merret parasysh se akuzat janë parashtruar gjatë dy datave të një pas njëshme (29.6.2019 dhe 30.6.2017), kohëzgjatja e procesit për aprovim të akuzës është e ndryshme, kështu që, në lëndët "Target - Kalaja", "Transport", "Total", dhe "Treqind" akuzat janë aprovuar për 2 deri në 3 muaj, ndërsa në lëndët "Tifani", "Trevnik", "Tenderë", "Titanik", ky proces ka zgjatur 6 deri në 7 muaj.

⁵ Neni 5 Rregullorja e gjykatës

Ditë



Burimi: Baza e të dhënave të Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë"

Faza e ardhshme, nga ana tjetër, nga aprovimi i akt akuzës deri në fillimin e gjykimit, edhe pse Ligji për procedurë penale parasheh se seanca kryesore caktohet në afat prej 30 përkatësisht 60 ditë (Për lëndë nga fusha e krimit të organizuar) nga dita e pranimit të akt akuzës në gjykatë, në rastin me lëndët e iniciuara nga PSP-ja, kanë kornizë kohore krejtësisht të ndryshme nga ajo që është parashikuar. Përkatësisht, mesatarisht, një seancë kryesore e cila është nga fusha e krimit të organizuar është caktuar për 55,8 ditë, që sugjeron numrin, larg mesatares së përcaktuar prej 30 ditë. Kur bëhet fjalë për lëndë nga fusha e krimit të organizuar, mesatarisht ato janë caktuar pas skadimit të 70.9 ditëve ose për dhjetë ditë më vonë nga e parashikuara. Koha mesatare e parashtrimit të akt akuzës në gjykatë deri në caktimin e seancës me rastin e këtyre lëndëve është 201 ditë, përkatësisht diçka më tepër se 6 muaj.

Përqindja më e madhe e këtyre lëndëve deri më sot ende është në fazë të veprimit dhe kjo pjesa dominuese e tyre në fazën e procedurës së parashtrimit të provave, ndërsa vetëm 4 janë kryer me vendim të plotfuqishëm⁶, ndërsa 3 janë në fazë të procedurës ankimore⁷. Lëndët e përfunduara, në parim si edhe procedurat penale të tjera “të rregullta”, janë përfunduar për një vit jo të plotë, me atë që lënda “Trast” është përfunduar në mënyrë të plotfuqishme për 8 muaj, lënda “Tifani përfundoj në një seancë gjyqësore sepse e akuzuara e pranoi fajin, ndërsa lënda “Kalaja 2” nuk është përfunduar në mënyrë të plotfuqishme vetëm për një të akuzuar, ndërsa për të akuzuarit të tjerë ka vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Më lartë tani më përmendëm se në Gjykatën Penale themelore janë formuar 5 këshilla, të cila vendosin në lidhje me procedurat gjatë të cilave nevojitet këshilla nga dy gjykatës, me gjykatës porotë plotësues. Një nga këto këshilla ka gjithsej 6 lëndë për procedim kur bëhet fjalë për lëndët e PSP-së. Në këto 6 lëndë, dy gjykatës profesionistë paraqiten si kryetarë dhe anëtarë të këshillit gjyqësor, përkatësisht të gjykatësit paraqiten si kryetarë në 3 lëndë edhe si anëtarë të këshillit gjyqësor në 3 lëndë. Që do të thotë, duke punuar të gjitha këto 6 lëndë, këta gjykatës në asnjë moment nuk guxojnë të lejojnë tu përputhen gjykimet për këto 6 lëndë, ndërsa duke e pasur parasysh se gjykimet për lëndët në pajtim me Rregulloren gjyqësore do të duhet të caktohen në çdo dy ditë, dhe mundësia për "përputhje" është shumë e madhe. Në veçanti që këto lëndë kanë materiale të shumta dhe dëshmi verbale, realizimi i të cilave imponon kohëzgjatjen më të madhe të vetë seancës gjyqësore, ndonjëherë edhe gjatë gjithë ditës së punës, që do të thotë se këta dy gjykatës nuk do të mundën në asnjë rast të arrijnë të punojnë edhe lëndë të tjera të cilat përfaqësohen nga prokurori të tjera. Në mënyrë plotësuese,

⁶ “Trast”, “Tifani”, “Kalaja 2”, “Tank” (dhe “Tank procedura e veçuar”)

⁷ “Tarifa”, “Trevnik” dhe “Treqind”

duhet të kemi parasysh se të gjithë gjykatësit, sipas orareve të cilat i kanë, nuk gjykojnë përditë, gjatë javës, përkundrazi ata gjykojnë gjatë dy ditëve të punës, që do të thotë mesatarisht nga 8 ditë në muaj. Rast të ngjashëm ka edhe me një këshill, në të cilin dy gjykatës kanë nga dy lëndë, por frekuenca e caktimit të këtyre lëndëve nuk është në atë masë dinamike si ato në këshillat që u përmendën paraprakisht.

Për momentin, nga nëntë gjykatës aktiv në Njësinë për Krim të Organizuar, tre gjykatës kanë nga 3 lëndë të PSP-së, dy gjykatës nga 2, dy gjykatës nga një lëndë dhe dy gjykatës të tjerë tek të cilët aspak nuk janë shpërndarë ky lloj i lëndëve. Dy gjykatës janë me nga 3 lëndë, siç përmendëm, gjykojnë së bashku në këshill, mirëpo i treti gjykatës është me 3 lëndë në këshill me gjykatës i cili nuk paraqitet në asnjë këshill tjetër dhe nuk ka asnjë lëndë të PSP-së, që në mënyrë plotësuese mundësonte kryetari i këtij këshilli në mënyrë intensive të shpërndajë lëndët, në ndërkohë të udhëheqë lënë të cilat nuk janë përfaqësuar nga ish PSP-ja (si për shembull 27 prill), ndërsa gjatë kësaj dy nga lëndët e PSP-së, tani më kanë përfunduar në mënyrë të plotfuqishme.

Ajo që i bën këto procedura dhe lëndë në përgjithësi komplekse dhe me shumë sfida janë nga njëra anë, rrethanat nën të cilat janë ngritur, ndërsa nga ana tjetër, "lufta" disa mujore e prokurorisë e cila inicioi me institucionet të tjera shtetërore në të cilat duhej të haste në partneritet dhe bashkëpunim për çrrënjosjen e krimit të organizuar dhe korrupsionin në shtet, por përkundrazi, ai u ballafaqua me obstrukcione të shumta dhe nuk hasi në bashkëpunim si dhe vëllim tepër të madh të dëshmive të propozuara ndërsa evidentë ato nuk janë infiltruar në masë të duhur. Pjesa më e madhe e lëndëve gjyqësore ballafaqohen me qindra dëshmi materiale dhe verbale, të cilat në këto faza duhet të realizohet sepse nuk kanë reaguar në kohë në lidhje me vëllimin dhe suficiencën e sasisë së caktuar të tyre, kështu, tani edhe pas mbajtjes së më shumë se pesëdhjetë seancave gjyqësore (lënda "Titanik"), procedura e paraqitjes së dëshmive ende nuk ka përfunduar. Në mënyrë plotësuese, gjykata tregon nivel relativisht të ulët të "përkushtimit" dhe më vëmendjes ndaj lëndëve për të cilat pritet të vjetërsohen, kështu menaxhimi i tyre i keq në fund rezulton me zgjidhje për refuzimin e akuzave për shkak të maturimit të ndjekjes penale (lënda "Trajektorja" për një nga të akuzuarit). Ndërsa si argument plotësues gjatë mbajtjes së dinamikës së keqe të lëvizjes së lëndëve numërohen dhe përsëritja e shpeshtë e lëndëve për shkak të qarkullimit për periudhë të caktuar kohore (lëndët "Tende" - dy herë, "Transportues", "Total", "Titanik 3", "Thesari", "Treqind", "Komuna Qendër"). Nga ana tjetër, mbrojtja pothuajse të gjitha lëndët, pa marrë parasysh faktin nëse ato kanë mundësi reale të maturohen për një, dy ose më tepër vite, e përdor çdo rast të mundshëm të prolongojë procesin. Mbrojtja i përdor të gjitha "adutët" e mundshme të cilat i ka në dispozicion – nga mungesa në seancat gjyqësore për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore të të akuzuarit, avokatit, dëshmitarit, nëpërmjet nevojës për kohë plotësuese për përgatitjen e mbrojtjes ose

marrjes në pyetje, deri në përdorimi i të gjitha ligjeve teknike të cilat ndikojnë mbi zbatimin e gjuhës në procedurën penale (lënda “TNT”).

Të gjitha këto parakushte dhe veprime të çdo njërit prej aktorëve në procedurë do të ndikojë mbi rrethanat nën të cilat mbahet procedura, si dhe mbi kohëzgjatjen e saj, efikasitetin dhe ekonominë. Procesi i transformimit të Prokurorisë Speciale Publike, përkatësisht “demontimin“ e saj, gjithashtu në të ardhmen pritet të ketë ndikimin e vet në pjesën e efikasitetit dhe mbi vetë prokurorët të cilët do të përfaqësojnë lëndët. Në veçanti në Prokuroria publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit nuk avancohet me burime njerëzore dhe kuadër për prokurorinë publike, ndërsa para së gjithash edhe me mbështetje financiare përkatëse nga buxheti.

Në drejtim të ekipimit të prokurorive publike, në pajtim *me Vendimin për përcaktimin e numrit të prokurorëve publik të prokurorive publike dhe prokurorëve publik në prokuroritë publike*⁸ të miratuar nga Këshilli i Prokurorëve Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, numri i parashikuar i prokurorëve publik në territorin e Maqedonisë së Veriut, është 257 pakurorë publik. Megjithatë, numrat e Raportit Vjetor të PSPRMV për vitin 2018 tregojnë se Prokuroria publike në Maqedoninë e Veriut funksionon me numër të reduktuar të prokurorëve publik për rreth 20%. Përkatësisht, nga 257 vendet të parashikuara për prokurorë publik në vitin 2018 ka pasur gjithsej 193 prokurorë. Gjendja është shqetësuese nëse kihen parasysh autorizimet e reja të prokurorëve publik në pajtim me Ligjin për procedurë penale. Kështu, në vend të përforsimit dhe rritjes së kuadrove të PPRMV kapacitetet e saj të reja po zvogëlohen. Në një pjesë kjo ka të bëjë me seleksionimin natyror (plotësimin e kushteve për pension të moshës) por në pjesë të mirë gjendja e këtillë është rezultat i mos funksionimit të sistemit të rregullit dhe trajnimit e kandidatëve për prokurorë publik. Në mënyrë plotësuese, numri i pamjaftueshëm i prokurorëve publik në shtet ishte vërejtur edhe nga Komisioni Evropian. Në Raport progresin për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019,⁹ është përcaktuar se Prokuroria Publike Themelore për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, nuk ka mjaftueshëm prokurorë publik, përkatësisht se janë plotësuar vetëm 10 nga 15 vendet e parashikuara.

Në mënyrë plotësuese, nga analiza e buxhetit të aprovuar të Prokurorisë publike, pjesa më e madhe e buxhetit janë shpenzime për paga dhe kompensime dhe kjo për çdo vit të analizuar, mbi 50 përkatësisht 60 përqind e buxhetit. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë konstante gjatë periudhës së analizimit dhe është një e treta e buxhetit

⁸ Vendimi është miratuar më 13.12.2019 botuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 18/19

⁹ E qasshme në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>

të aprovuar. Megjithatë, ajo që shqetëson më tepër është përqindja e mjeteve të aprovuara për investime kapitale në prokuroritë publike i cili ndryshon ndërmjet 4 dhe 5 përqind nga buxheti përgjithshëm i aprovuar për prokuroritë publike. Duke pasur parasysh se shpenzimet kapitale në fakt paraqesin investime për mirëmbajtje dhe avancim të ndërtesave dhe pajisjeve të prokurorive publike, duhet të plotësohet urgjentisht zmadhimi i mjeteve për këtë lloj të shpenzimeve.



1.3. Shkaqe për prolongimin e seancave gjyqësore

Siç u përmend paraprakisht, lëndët e PSP-së, kishin kompleksitetin e tyre dhe jo vetëm për shkak të natyrës së veprave penale të cilat ndiqen por edhe për shkak të rrethanave shoqërore dhe klimës politike në vend, që vet vetiu kontribuoi këto lëndë të ballafaqohen me ngecje në të gjitha fazat e procedurës. Megjithatë, nëse shihet statistika e përgjithshme për lëndët e PSP-së, mund të vërejmë se ato mbahen shumë më shpesh sesa lëndët të tjera të cilat kanë të bëjnë me korrupsionin ose krimin e organizuar. Kështu, sipas të dhënave të Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë", deri më tani mesatarisht seancat gjyqësore për seancën kryesore të lëndëve të PSP-së, prolongohen në diçka më pak se një e treta e rasteve, që është krejtësisht në kundërshtim me rastet të tjera të cilat mbahen në Njësinë për krim të organizuar dhe korrupsion dhe të cilat sipas të dhënave të Koalicionit prolongohen në pothuajse dy të tretat e rasteve. Mirëpo edhe përpos kësaj, pjesa më e madhe e lëndëve të PSP-së gjenden në fazë të procedurës së dëshmimeve e cila zgjat më tepër se një vit për të gjitha këto lëndë, ndërsa prolongimi në disa nga lëndët, kontribuoi edhe për fillimin e përsëritur të seancës kryesore për shkak të skadimit të 90 ditëve.

Si lëndë referentë për nevojat e kësaj analize do të merren lëndët të cilat marrë stilistikisht kanë përqindje më të madhe të seancave të prolonguar si dhe lëndë tek të

cilat këshilli gjyqësor përputhet me qëllim të theksohen problemet të cilat janë kryesore për udhëheqjen efikase dhe të pa penguar të procedurave gjyqësore.

Sa i përket prolongimit, ndërsa në favor të tezës, mbrojtja shpesh di të prolongojë procedurën, pa marrë parasysh atë nëse është në interes të të akuzuarve ose jo, dhe për këtë flet pjesa e statistikës sipas së cilës numri i madh i diskutimeve është pikërisht me kërkesë të mbrojtjes. Prolongimet e kërkesës së mbrojtjes përfshijnë mungesat e të akuzuarve ose mbrojtësve të tyre nga seancat, si dhe prolongimet të cilat janë shkaktuar për të gjitha veprimet e proceseve të mbrojtjes, siç janë kërkesat për përgatitjen e mbrojtjes, këqyrja në dëshmitë, kërkesa për përjashtimin e gjykatësit etj. Është me rëndësi të përmendet se prolongimi për shkak të mungesës së të akuzuarve nuk janë proporcionale në të gjitha lëndët, kështu në një pjesë të lëndëve të PSP-së të cilat kanë kohëzgjatje më të madhe të procedurës, të akuzuarit kanë munguar shumë pak ose po, aspak. Në lëndët "Tarifa", "Trajektorja" dhe "Tenderë" të akuzuarit nuk kanë munguar, ndërsa në "TNT", "Titanik", "Toplik" dhe "Transporter" janë vërejtur mungesa minimale të të akuzuarve, ose mungesë në më pak se 20% seancave gjyqësore për seancën kryesore. Si mesatare e përgjithshme e prolongimit për shkak të mbrojtjes (mungesë, kërkesë për prolongim dhe aktivitete të tjera për shkak të të cilave ka ndodhur prolongimi i diskutimit) për të gjitha lëndët është nën 40%¹⁰. Kjo do të thotë se prolongimi me kërkesë të mbrojtjes faktorit më të madh individual për ngecjen e procedurave (për dallim nga ato të gjykatës ose PSP-së) por megjithatë, nëse merret parasysh se ato janë nën 40%, do të thotë se pjesa më e madhe e tyre janë prolonguar në kombinim me faktorë të tjerë së këndejmi do të ishte e përsheptuar të konkludohet se mbrojtja është faktori kryesor për prolongimin.

Nga prolongimet të cilat janë shkaktuar si pasojë e drejtpërdrejtë e sjelljes së mbrojtjes, në mënyrë dominuese veçohen shkaqet siç janë gjendja shëndetësore e përkeqësuar e atë akuzuarve, si dhe obligimet zyrtare të të akuzuarve të cilët në masë të madhe ende janë bartës të funksioneve publike. Në të gjitha rastet e mungesës së personave të akuzuar, ata në mënyrë përkatëse e kanë arsyetuar me dorëzimin e dokumentacionit mjekësor të rregullt dhe kjo zakonisht e dorëzuar nga vetë mbrojtësit të cilët kanë qenë të pranishëm në seancën gjyqësore. Është interesante se në kontekst të kësaj, gjykata shumë rrallë investon përpjekje të kontrollojë arsyetimin e këtyre mungesave të të akuzuarve, në veçanti në drejtim të obligimeve zyrtare të personave të akuzuar. Është me rëndësi të përmendet se gjykata duhet të bëjë gradimin e obligimeve zyrtare të personave të akuzuar dhe duke pasur parasysh edhe atë se ai vetë është

¹⁰ Përqindja ka të bëjë me mesataren e përgjithshme për të gjitha lëndët e përfshira në këtë analizë ndërsa prolongimet janë prej 0% në "Tank" deri në 100% në "Talir"

shtyllë e pushtetit paralel me Kuvendin dhe Qeverinë, të pranojë vetëm ato mungesa të të akuzuarve të cilat janë të nevojshme për funksionimin e shtyllave të tjera të pushtetit. Së këndejmi, krejtësisht është e pranueshme dhe e kuptueshme mungesa për shkak të obligimeve siç është votimi i ligjeve të rëndësishme ose ligje jo miratimi i të cilave mund të shkaktojë dëm të madh mbi shoqërinë, por këto obligime zyrtare zakonisht u janë të njohura vetë të akuzuarve, paraprakisht, kështu gjykata mund të bëjë përpjekje për koordinim të më suksesshëm dhe menaxhim të orarit të seancave gjyqësore të caktuara për debatin kryesor, me qëllim të evitohet përputhjen e seancave gjyqësore me obligime të këtitilla urgjente dhe të pa prolongueshme të të akuzuarve. Në kontekst të kësaj është edhe mendimi i Parlamentit Evropian i BE-së, sipas së cilit gjykata duhet të arrijë baraspeshë të drejtë ndërmjet efikasitetit të procedurës dhe kryerjes së funksioneve zyrtare në shtet të cilat janë parashikuar me Kushtetutën, gjatë çka gjykata është e obliguar të zbatohet kriterin e qëllimeve legjitime dhe proporcionale¹¹.

Nga ana tjetër, në pajtim edhe me praktikë e GjEDNj, e drejta e një personi të mungojë në gjykim nuk është absolute dhe prandaj me rëndësi të veçantë është gjykata të përcaktojë nëse mungesa e personit të akuzuar është për shkak të heqjes së dorës nga ai në mënyrë vullnetare nga kjo e drejtë, ose i akuzuari nuk ka mundur të ndikojë mbi shkaqet, të cilat janë ndikuar mbi mundësinë e mos prezencës së tij. Për fat të keq, GjEDNj nuk ofron mundësi të veçanta dhe të sakta të procesit dhe autorizime të gjykatës për kontrollimin e arsyeshmërisë së mungesës së personave të akuzuar, as që ofron përkufizime për atë kur një mungesë konsiderohet si e arsyeshme. Opsioni i vetëm të cilin e ofron LPP është detyrim paraqitja dhe mundësia për përcaktimin e masës ndalim në rastet kur personi i akuzuar me qëllim eviton të marrë pjesë në diskutimin, por në këtë rast duhet të ekzistojnë prova të qarta se personi me qëllim mungon nga diskutimi. Nga ana tjetër, pikërisht për shkak të formulimeve “të dobëta” në LPP si dhe mungesa e ndalimeve gjyqësore të ri kontrollojë konstatimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga mbrojtja në drejtim të arsyeshmërisë së mungesës, gjykata duhet të marrë rol më aktiv në menaxhimin e diskutimeve dhe koordinim me të gjithë pjesëmarrësit në procedurën, në mënyrë që të evitohen prolongimet e panevojshme të procedurave. Duke pasur parasysh këtë, gjykatat duhet të veprojnë me vëmendje të madhe gjatë këtyre situatave me qëllim të mos vendoset praktikë gjyqësore jo përkatëse e cila do të pranohej nga gjykatat të tjera, ndërsa do të ishte në drejtim të veprimit gjyqësor jo efikas dhe të mefshtë.

Megjithatë, prolongimet që kanë ndodhur me kërkesë të mbrojtjes jo çdo herë janë pasojë e drejtpërdrejtë e sjelljes së të akuzuarve ose mbrojtësve. Kështu, përqindje solide e prolongimit të këtyre lëndëve, në veçanti ato të cilat kanë ndodhur në fillim të

¹¹ [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2015/536461/IPOL_IDA\(2015\)536461_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2015/536461/IPOL_IDA(2015)536461_EN.pdf)

proceseve gjyqësore, përkatësisht para fillimit të procedurës së vërtetimit, kanë të bëjnë me mos pasjen e kohës përkatëse dhe kushteve për përgatitjen e mbrojtjes. Si shkak kryesor për këtë janë reagimet të mbrojtjes, se nuk u është dhënë qasje drejt dëshmive të lëndës, ose se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për tu njoftuar me materialet e provës, në veçanti në lëndët ku ka më tepër prova nga PSP-ja. Në këtë drejtim është vërtet e pa kuptueshme si edhe gjykata edhe prokuroria kanë lejuar deri te situata mbrojtja mos ketë qasje përgatëse në provat dhe kushte përkatëse për përgatitjen e mbrojtjes para fillimit të procedurës gjyqësore, në veçanti nëse merret parasysh se LPP dhe KEDNJ parashikojnë i akuzuari të njoftohet me të gjitha dëshmitë të cilat vijnë së bashku me vërtetimin e fajit, si dhe me provat të cilat shkojnë në favor të lirit nga përgjegjësia. Pikërisht për shkak të mos plotësimit të këtyre obligimeve, para së gjithash nga prokuroria, ndërsa më pas edhe nga gjykata, prolongimet të cilat janë shkaktuar në rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës për shkak të kërkesës së mbrojtjes për kohë plotësuese për njoftim me provat, nuk mund të konsiderohen si prolongime të cilat kanë ndodhur për shkak të sjelljes së mbrojtjes.

Edhe një sfidë në menaxhimin me procedurat, përpos problemeve të përgjithshme paraprake të përshkruara me përputhjen e gjykatësve në më shumë lëndë, është edhe përputhja e më shumë të akuzuarve por edhe më tepër mbrojtësve në disa nga lëndët e PSP-së. Edhe pse përputhja në terminet për dy gjykime ku ka të akuzuar të njëjtë në esencë janë ndër shkaqet më të vogla për prolongim, ekzistimi i tyre në numër relativisht të vogël të lëndëve sugjeron pasivitetin tepër të madh të gjykatës në rolin e saj si menaxher dhe koordinues i dinamikës dhe orareve të zhvillimit të të gjitha veprimeve në procedurat të cilat janë në fazë gjyqësore. Është interesante edhe ajo se nuk ekziston korrelacion ndërmjet numrit të të akuzuarve në lëndën dhe frekuencën ose mundësinë e përputhjes së terminëve për gjykime. Në mënyrë plotësuese, gjykata ende nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për avancimin e koordinimit të gjykatave ndërmjet vete, as për përputhjen pro aktive të kryetarit të gjykatës në vendimmarrje në lidhje me atë nëse lëndë të caktuara do të konsiderohen si prioritet në pajtim me Rregulloren gjyqësore. Edhe pse për nuancë është më pas serioze, e ngjashme është situata edhe me përputhjen e lëndëve të ndryshme ku paraqitet mbrojtësi i njëjtë. Situata e këtillë është përcaktuar si problematike para se të fillojë me punë PSP-ja, por as gjykata, as prokuroritë, as Oda e avokatëve nuk kanë bërë përpjekje për gjetjen e zgjidhjeve praktike ku do të mund të integrohej orari i punës për të gjitha palët e interesuara me qëllim, koordinim më të lehtë dhe evitimin e përputhjes.

Faktorëve të lartë përmendur për prolongimin e procedurave u ndërlidhen faktorë të tjerë, të cilët tërësisht janë në kompetencë të plotë të gjykatës, sikurse këshilli gjyqësor jo i plotë, ose mungesa e gjykatësit individual, ndryshimi i anëtarëve të këshillit gjyqësor, mos pasja e kushteve teknike ose hapësinore për punë, caktimi i seancës

gjyqësorë para kryerjes së ekspertizës gjyqësore që duhet të realizohet në seancën gjyqësore etj. Sipas statistikave të Koalicionit, pothuajse 25% e të gjitha prolongimeve të shkaktuara për shkak të mos pasjes së kushteve përkatëse teknike dhe hapësinore, ose për shkak të mungesës së anëtarit të këshillit gjyqësor, përkatësisht në një të katërtën e seancave të prolonguara, kjo ka ndodhur si pasojë e sjelljes së gjykatës. Një pjesë e prolongimeve kanë ndodhur për shkak të mungesës së anëtarit të këshillit gjyqësor që lidhen me përputhjen e terminëve për lëndë ku paraqitet gjykatësi i njëjtë, ndërsa janë vërejtur edhe lloj tjetër i mungesave të gjykatësve. Në masë të madhe kjo mund të ndërlihet edhe me ndryshimin e kuadrit të Njësisë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion e cila duke filluar nga viti 2018 punon me 3 gjykatës më pakë që është reduktim i kuadrit të kësaj njësie për 25%.

Ajo që gjithashtu është imponuar si temë e hidhur, ndërsa gjithashtu ka të bëjë me menaxhimin e resurseve njerëzore ishte ndryshimi i anëtarëve të këshillit gjyqësor. Përpos në një moment ("Titanik 3") ku gjykatësi profesional përjashtohet nga veprimi para fundit të vetë procedurës në të gjitha rastet të tjera ishte bërë ndryshimi i gjykatësit - porotë. Në veçanti ishte problematik mandati i një gjykatësi porotë i cili ishte anëtar i këshillit në katër lëndë në PSP ("TNT", "Titanik", "Monstra" dhe "Talir"), për çka në publik u paraqitën interpretime të ndryshme për atë nëse dhe si duhet të veprojë gjykata në këtë situatë. Problemin me mandatin e porotës e theksuan avokatët në një nga lëndët dhe ata përmendën se porotës i ka skaduar mandati 4 - vjeçar, si dhe se tani për atë është paraqitur kufiri i moshës për ushtrimin e funksionit gjykatës - porotë. Veprimi në gjykatë, por edhe në Këshillin gjyqësor, në këtë situatë ishte shumë pasive dhe filli të ndërmarra masa për tejkalimin e situatës vetëm mbasi problemi u bë publik. Veprimet e ndërmarra nga gjykata në masë të madhe ishin vetëm deklarative dhe përipiqej të gjejë zgjidhje me kompromis nëpërmjet zbatimit të dispozitave të Ligjit për marrëdhënie pune, ndërsa Këshilli gjyqësor asnjëherë nuk u prononcua në lidhje me këtë situatë. Gjatë pjesës më të madhe të kohës, Këshilli gjyqësor dhe gjykata ishin përfshirë në korrespondenca dhe debate publike me avokatët, sesa që është kushtuar vëmendje për tejkalimin e kësaj situatë dhe gjetjen e zgjidhjeve për evitimin e ardhshëm të situatave të këtilla dhe të ngjashme. Epilogu i fundit ishte tërheqja e gjykatësit porotë nga funksioni ndërsa me këtë edhe përsëritja e pa evitueshme e filmit të këtyre procedurave, me çka gjithsej 15 procedura të PSP-së do të kenë përsëri fillimin e tyre, pa marrë parasysh nëse do të jetë vetëm formal ose përsëri me nxjerrjen e dëshmive të njëjta.

Nga aspekti i menaxhimit të rrjedhës së procedurave, disa herë gjykata nuk kishte siguruar kushte përkatëse hapësinore dhe teknike për mbajtjen e gjykimeve, që duket si veprim jo serioz nga gjykata sepse ekzistonte interes i madh publik me të cilin u ndoqën këto procedura dhe gjykata është dashur të sigurojë kushte përkatëse për mbajtjen e seancave. Në kontekst të kësaj, për tu theksuar është edhe shkalla e prolongimit të mbi

20% për shkak të mos sigurimit të dëshmitarit, ekspertit gjyqësor ose ekspertizës gjyqësore. Edhe pse në pajtim me modelin e ri të procedurës penale adversarijale, dëshmitarët thërriten si mjet dëshmie për secilën palë e cila i propozon, te një pjesë e ekspertëve u paraqit mendimi se pikërisht për shkak të dobisë nga mjeti dëshmues të cilin e ka pasur pala e cila e propozon dëshmitarin, se ajo është dashur të bëjë përpjekje ta sigurojë prezencën e tij, megjithatë gjykata nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia në rastet kur ka mungesë të dëshmitarëve dhe ekspertëve ligjorë. Në pajtim me LPP gjykata është ajo e cila është e obliguar të sigurojë rrjedhën e pa penguar të procedurës, ndërsa në pajtim me praktikën e GjEDNj gjykata duhet të bëjë gjithçka që është në kompetenca të saj të përdorë të gjitha mjetet të cilat i ka në dispozicion me qëllim të mund të abstraktohet nga përgjegjësia dhe shkaqet për prolongim ti referohen pjesëmarrësve të tjerë në procedurën.

Kështu, nëse shihen në mënyrë të kombinuar të gjitha prolongimet e seancave gjyqësore të cilat janë shkaktuar si pasojë e drejtpërdrejtë e sjelljes së gjykatës (25% për shkak të mos pasjes së kushteve përkatëse ose mungesës së anëtarit të këshillit) ose si pasojë e pasojës indirekte të përkushtimit të pa mjaftueshëm dhe angazhimit në menaxhimin dhe koordinimin e proceseve (20% për shkak të mos sigurimit të ekspertëve, dëshmitarëve dhe ekspertizave ligjore) do të vëremë se sjellja e gjykatave është shkak për prolongim në 45% të rasteve, për dallim nga 40% të prolongimit për shkak të sjelljes së mbrojtjes.

Sjellja e PSP-së paraqitet si shkak më i vogël për prolongim, që në masë të madhe është më ndryshe nga statistika e prokurorive të tjera, ku mungesa e prokurorit është shkak i dytë për prolongim, menjëherë pas mungesës së mbrojtjes. Vetëm në 10% të rasteve kur ka pasur prolongim, ndërsa kjo është bërë për shkak të sjelljes së prokurorëve publik dhe kjo në masë të madhe nga këto raste ka qenë për shkak të transformimit të PSP-së dhe ndërmarrjes së lëndëve nga PPRM, përkatësisht nuk veprojnë si pasojë e sjelljes së të akuzuarve, por si pasojë e mos pasjes së vullnetit politik për tejkalimin e problemeve dhe situatave kontroverse me PSP-në dhe të ardhmen e saj. Megjithatë, në masë të caktuar edhe sjellja e PSP-së kontribuon drejt zgjatjes së dinamikës me të cilën zhvillohen këto procese më saktë me propozimin e numrit të madh të dëshmimeve. Shkaqet për veprimin e këtillë nga PSP-ja nuk janë publikuar zyrtarisht, por jo formalisht bëhet fjalë për pasojë të ankesës dhe përpjekjes të lihet imazh i mirë për punën transparente, kështu që PSP i ka propozuar të gjitha provat me të cilat disponon ndërsa të cilat kanë të bëjnë me lëndë konkrete me qëllim mos ketë dyshime për fshehjen e provave. Për fat të keq, kjo rezultoi me raste ku janë paraqitur 2000 dëshmi materiale ("Transporter"), 100 dëshmitarë ("Target/ Kalaja") dhe 200 dëshmitarë dhe 6000 dëshmi materiale ("Titanik") me çka është bërë një presedan i llojit të vet në veprimin e prokurorive publike. Megjithatë, ajo që gjithashtu është e rëndësishme të përmendet në këtë situatë është

fakti se gjykata, gjatë vlerësimit të akt akuzës si dhe vetë seancës kryesore, i ka pranuar të gjitha dëshmitë të cilat i ka paraqitur PSP-ja, pavarësisht për cilat rrethana bëhet fjalë dhe jo vetëm duke i marrë parasysh ekonominë dhe sa ekspeditive është procedura, të cilat në fakt janë argumenti kryesor për refuzimin e dëshmive të propozuara të mbrojtjes, në veçanti nëse bëhet fjalë për dëshmitar të njëjtë të propozuar nga të dyja palët. Numri i madh i dëshmive pa dyshim ndikon gjatë procedurës dhe shpejtësinë me të cilën zhvillohen gjykimet, por në këtë drejtim është me rëndësi të përmendet se të gjitha hetimet ishin kryer për më pak se dy vjet nga formimi i PSP-së ndërsa për atë periudhë ishin grumbulluar dhe përpunuar të gjitha dëshmitë të cilat janë paraqitur. Sipas kësaj analogjie, gjykata nuk do të duhet të ketë vështirësi të nxjerrë dëshmitë në procedurën e parashikuar me ligj dhe për periudhë më të shkurtë kohore nga kohëzgjatja e hetimit, por në këtë rast dhe deri në këtë moment procedurat gjyqësore, një pjesë nga të cilat nuk kanë as aktvendim gjyqësor të plotfuqishëm të shkallës së parë, zgjasin dukshëm më gjatë se vete hetimi.

1.4. Vetia e personave të akuzuar në procedurat

Vetia e të akuzuarve në këto lëndë duhet të merret parasysh gjatë shqyrtimit të veprimit të të gjitha palëve të interesuara, sepse për herë të parë në gjyqësorin maqedonas hasen kaq shumë lëndë të kësaj natyre. Në numrin më të madh të lëndëve, të akuzuarit janë ish funksionarë të lartë ose funksionarë aktual ose persona të shquar nga jeta politike, ndërsa veprat me të cilat ngarkohen janë vepra me të cilat gjykatat tonë dhe prokuroritë nuk kanë përvojë. Kjo është me rëndësi të veçantë kur analizohet lënda “Talir” ku si person i akuzuar për herë të parë gjendet parti politike, përkatësisht partia më e madhe politike në shtet. Lënda konkrete ende nuk ka hyrë në procedurë të paraqitjes së dëshmive dhe shënon shkallë shumë të lartë të seancave gjyqësore të prolonguar (100% prolongim, pjesa më e madhe e tyre si pasojë e mbrojtjes) edhe pse bëhet fjalë për rast ku është ngrirë një pjesë e pronës së partisë politike, që sipas praktikës së vendosur dhe Rregullores gjyqësore do të duhet të paraqesë bazë për përcaktimin e lëndës konkrete me prioritet. Situata është komplikuar në mënyrë plotësuese me kërkesat për konfiskimin e pronës partiake të fituar në mënyrë joligjore ndërsa me këtë masë organet vendose kanë vetëm përvoja të kufizuara të cilat kanë të bëjnë me shuma tepër të vogla të konfiskuara nga kryerës jo aq të njohur. Për këto shkaqe, gjykata rrallë guxon të “vendosë” dhe të mos i lejojë mbrojtjes të kërkojë prolongimin e mëtutjeshëm që të mos ndodhë shkelje eventuale të ndonjë prej të drejtave proceduese që do të mund të rezultonte me përsëritjen e procedurës, shpenzime plotësuese dhe dëmtimin eventual të buxhetit të RMV si pasojë e pagesës së dëmit për shkak të shkeljes së procedurës, por dhe për shkak të përshtypjes që do të lihej në publik, përsëri, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për partinë politike më të madhe në vend.

Sa u përket personave fizik të akuzuar, nga ana tjetër, nuk mund të vërehet trend i caktuar i veprimit të gjykatës ose prokurorisë që lidhet me funksionin ose vetitë personale të të akuzuarve, kështu një nga lëndët më shpejt të zgjidhur është pikërisht ("Tank") në të cilën i akuzuar ishte ish kryeministri i RMV (i cili tani është në arrati) ndërsa një pjesë e lëndëve ku janë të akuzuar persona të cilët nuk janë bartës të funksioneve (për shembull "Total" ku i akuzuar është gazetar dhe disa persona të tjerë juridik) është lëndë me më shumë prolongime dhe më pak veprime proceduese të ndërmarra edhe pse të dyja gjykimet ("Total" dhe "Tank") kishin filluar pothuajse në të njëjtën periudhë kohore.

Pjesa 2: Ndryshime të Kodit penal dhe efektet mbi lëndët e PSP-së

2.1. Çfarë sollën ndryshimet? -Analiza e kornizës ligjore

Në fund të vitit 2018 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të RM-së, i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2019.¹² Një pjesë e intervenimeve të parashikuara në Ligj ishin pozitive dhe ndryshime esenciale të materies penale – juridike, në veçanti ndryshimet e shumë pritura për ndjekjen përkatëse dhe sanksionimin e veprave penale të kryera nga urrejtja, si dhe vendosja e dispozitave të reja për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe dispozita për sanksionimin e pengesës së drejtësisë. Mirëpo, një pjesë e ndryshimeve dhe plotësimeve, pa u arsytuar në mënyrë përkatëse si nga propozuesi ashtu edhe nga ligjvënësi, lanë hapësirë për spekulime, në veçanti rreth shkakut të vërtetë për miratimin e tyre. Në këtë drejtim hynë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet në drejtim të nenit 40 (Zbutja e dënimit), neni 275-v (Keqpërdorimi i procedurës për thirrje publike, ndarja e marrëveshjes për prokurim publik ose partneritet publiko - privat) dhe neni 279-a (Mashtrim tatimor).

Shkaku pse këto ndryshime dhe plotësime shkaktuan reagim nga sektori civil dhe ekspertët, përpos faktit se nevoja për këto ndryshime aspak nuk ishte arsytuar, ndër të tjerat është edhe ndikimi mbi lëndët rrjedhëse për korrupsion të lartë të iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike.

Me ndryshimet dhe plotësimet e KP, me nenin 279-a u vendos kinse vepër e re penale "Mashtrim tatimor". Nëse analizohen me detaje nenet më poshtë, mund të shihet se bëhet fjalë për kriminalizimin e veprave të njëjta. Kështu, me nenin 279 përcaktohet dënimi për të cilin çdo person i cili pjesërisht ose tërësisht do të evitojë pagesën e tatimit ose detyrimin tjetër nëpërmjet dhënies së informacioneve të rrejshme për të ardhurat e

¹² Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të RM-së, Gazeta Zyrtare e RMV-së 248/2018 të datës 31.12.2018

tij, ndërsa me nenin e ri 279-a përcaktohet dënimi për çdo person i cili me qëllim të fitojë dobi pronësore e vë në huti organin nëpërmjet dhënies së informacioneve të rrejshme dhe do të kërkojë zvogëlimin e obligimit për pagesën e tatimit, ose do të kërkojë kthimin e tatimit. Është evidente se këto nene inkrimojnë veprime identike dhe se të dyja veprat kanë të bëjnë me abuzime tatimore me vlerë më të madhe. Mirëpo, ligjvënësi ka menduar se edhe përkaj asaj që bëhet fjalë për inkriminim të veprave të njëjta dhe identike, duhet të ketë dy vepra penale të veçanta, të cilat për veprime penale të njëjta do të parashikojnë shkallë të ndryshme të dënimit. Kështu, për vepër penale tani më ekzistuese “evazion tatimor” ligjvënësi kishte parashikuar dënim me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa me veprën e re penale nga neni 279-a “evazion tatimor” për veprime të njëjta ligjvënësi ka përcaktuar sanksion drastikisht më të vogël prej 6 muaj deri në 3 vjet.

Evazion tatimor

Neni 279

Ai i cili me qëllim vetë ai ose dikush tjetër të evitojë pagesën e plotë ose të pjesëshme të tatimit, kontributit ose ndonjë detyrimi tjerët për të cilin është i obliguar me ligj, jep të dhëna të rrejshme për të ardhurat e vet ose për të ardhurat e personit juridik, lëndët ose fakte të tjera nga ndikimi për përcaktimin e shumës së detyrimeve të këtilla ose ai i cili me qëllim të njëjtë në rastin e paraqitjes së detyrueshme të të ardhurave, nuk i paraqet të ardhurat, përkatësisht lëndë ose fakt tjetër nga ndikimi për përcaktimin e detyrimeve të këtilla, ndërsa shuma e detyrimit është me rëndësi të madhe, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me dënim me para.

Evazion tatimor

Neni 279 – a

Ai i cili me qëllim për vete ose për tjetër fiton dobi pronësore në mënyrë joligjore, organit tatimor i jep të dhëna të rrejshme në flet paraqitjen tatimore, me çka do të vërë në huti organin tatimor, me qëllim në mënyrë të pa bazuar të kërkojë kthimin e tatimit ose zvogëlimin e detyrimit për tatim, me vlerë më të madhe, do të dënohet me dënim me burg prej gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me dënim me para.

Duke se ligjvënësi gjatë vendosjes së veprës së re penale nuk ia ka dalë të japë përgjigje për çështjet esenciale të cilat mund të paraqiten gjatë zbatimit të tyre, në kuptim të praktikuesve, përkatësisht se si prokurorët dhe gjykatësit do ti kuptojnë dhe

si do ti zbatojnë këto dy nene të KP. Në mënyrë plotësuese, ligjvënësi nuk e ka marrë parasysh nëse në praktikë këto dy nene mund të rezultojnë me çrregullim serioz të sigurisë juridike të qytetarëve dhe zbatimit jo të barabartë të dispozitave konkrete të Ligjit, nëpërmjet veprimit seleksionues dhe të pa barabartë në varësi të asaj kush duhet të përgjigjet për veprat e këtilla. Më e rëndësishmja, në asnjë pjesë të vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNRr) gjatë miratimit të ndryshimeve, ligjvënësi nuk e pa të nevojshme të sqarojë arsyen për vendosjen e politikës ndëshkuese e cila më butë do të trajtojë keqpërdorimet tatimore.

Nëse e analizojmë këtë nen nga aspekti i lëndëve aktuale, kualifikimi i akuzës për lëndën "Total", thotë: *"I akuzuari D.P.L si drejtues i DM T.M.A. SHPKNJP me qëllim ai dhe shoqëria të evitojnë pagesën e pjesshme të tatimeve (me qëllim të fitojnë dobi pronësore në mënyrë joligjore), në evidencën kontabiliste të shoqërisë, llogaritë përfundimtare dhe flet paraqitjet tatimore ka dhënë informacione të rrejshme për faktet nga ndikimi për përcaktimin e shumës së obligimeve tatimore (që ka rezultuar me mashtrim të organit tatimor) e njëjta mund të iniciohet në bazë të dy neneve.* Kjo do të thotë se në rastin konkret ekzistojnë dy mundësi jo vetëm prokuroria publike të ri kualifikojë veprën në akuzë, por edhe mundësi gjykata gjatë miratimit të aktvendimit gjyqësor të ndryshojë vlerësimin juridik të veprës në pajtim me nenin 398, paragrafi 2 i LPP. Në këtë rast, me zvogëlimin e dënimit, do të zvogëlohen afatet për maturimin e lëndës, me çka në rastin konkret do të ndodhë maturimi absolut për veprat e kryera para vitit 2013. Maturimi paraqitet për shkak se neni i ri parasheh dënim me burg deri në 3 vjet, që do të thotë se në pajtim me nenin 107, paragrafi 5 i KP, maturimi relativ do të shkaktohet për 3 vjet, ndërsa maturimi absolut në pajtim me nenin 108, paragrafi 6 do të ndodhë për 6 vjet.

Edhe pse, në rastin konkret, akuzat e kualifikon veprën si vepër penale e vazhduar në pajtim me nenin 45 të KP, sipas së cilës duhet të konsiderohet se maturimi ndodh si pasojë e veprimit të ndërmarrë, përkatësisht nga data 15.03.2016, megjithatë gjykata mund të vlerësojë nëse bëhet fjalë për vazhdimin e veprës penale dhe të konsiderohet se vepra individuale të kryera nga viti 2008 përfshirë vitin 2013 janë maturuar¹³. Me këtë nen do të mund të ketë edhe pasoja shumë të mëdha të cilat do të ndikojnë jo vetëm mbi punën e prokurorive dhe gjykatave, por edhe mbi punën e organeve të tjera të cilat duhet të ballafaqohen me krimin ekonomik, përkatësisht me krimin e "jakave të bardha".

¹³ Shih më tepër: Aktvendimi gjyqësor Kzz nr. 7/2007 të datës 28.03.2007 i Gjykatës supreme "Lidhja kohore si element i vazhdimin të veprës penale nuk mund të bashkëngjitet pas disa muaj, konsideruar nga njëri veprim në tjetrin", si dhe aktvendimi gjyqësor Kvp, nr. 56/2013 të datës 30.04.2013 të Gjykatës supreme „Nga përmbajtja e dispozitës ligjore në fjalë (neni 45 të KP) mund të konkludohet se elementë të vazhdueshëm konstituiv të nocionit vepër e vazhduar penale të cilat duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, janë: identiteti i kryerësit, vepra të të njëjtit lloj në lidhje kohore.“

Në nenin 275-v të KP, ndryshmet janë në paragrafin 3, ku fjala “pesë” zëvendësohen me fjalën "katër" ndërsa kanë të bëjnë me dënimin minimal të përcaktuar për atë veprë penale konkrete. Konkretisht këto ndryshime lidhen me lëndën "Trast" e cila ka të bëjë me nenin konkret dhe paragrafin (neni 275-v, paragrafi 3) përfshirë me ndryshimet e KP, ndërsa paralajmërimet janë në lidhje me zvogëlimin e dënimit në 4 vjet burg, që hap mundësi të akuzuarit në këtë rast dënimi tu zbutet në 2 vjet, dhe në mënyrë konsekuente me këtë, dhe në pajtim me nenin 50 të KP, të akuzuarve do tu shqiptohet dënim me kusht. Njëkohësisht, drejtpërdrejtë ndikon në mundësinë për maturimin më të shpejtë të veprës penale. Pasojat nga ky ndryshim drejtpërdrejtë reflektohen mbi lëndën e PSP-së i njohur si “Trast” përkatësisht veprat në vend të maturohen në vitin 2031, do të maturohen në vitin 2021.

Neni 40 i KP, i cili i rregullon kufijtë e zbutjes së dënimit nën afatin e përcaktuar me ligj, u ndryshua me ndryshimet e reja të KP nga dhjetori i vitit 2018, kështu që u kthye formulimi i vjetër i paqartë në paragrafin 2 të nenit, ndërsa i cili thotë se gjykata mund të përcaktojë sanksion nën minimumin e parashikuar me ligj kur “do të konstatohet se ekzistojnë rrethana në veçanti lehtësuese të cilat sugjerojnë se edhe me dënim të zbutur mund të arrihet qëllimi i dënimit”. Ky formulim u hoq nga KP në vitin 2013 pikërisht për shkak të praktikës gjyqësore të pa barabartë dhe argumentimit të pa mjaftueshëm për ekzistimin e rrethanave me lehtësim të veçantë nga gjykatat kur vendosën ta zbatojnë këtë nen, ndërsa gjithashtu u vendosën edhe kritere të qarta për atë, kur mund të zbutet dënimi nën minimumin ligjor.

Qeveria propozonte edhe ndryshimet të nenit 353 të KP, i cili ka të bëjë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare dhe autorizimeve, por nën presion të publikut hoqën dorë nga ky propozim. Nëse miratohej, kjo do të thoshte maturim edhe i disa rasteve të PSP-së.

KONKLUZA DHE REKOMANDIME

Mungesa e gjykatësve në Gjykatën Themelore Penale në Shkup, shpërndarja jo e barabartë e lëndëve, roli pasiv i gjykatës në menaxhimin e seancave gjyqësore, kufizimi i kapaciteteve të PTHPNKOK, miratimi i ndryshimeve ligjore dhe ligjeve sistemore me procedurë të shpejtuar pa vlerësim përkatës të ndikimit të ndryshimeve janë vetëm një pjesë e faktorëve të cilët ndikojnë në rrethanat nën të cilat mbahet procedura, si dhe mbi kohëzgjatje e saj, efikasitetin dhe ekonominë.


Me qëllim avancimin e efikasitetit të drejtësisë penale, nevojitet angazhim serioz i shtetit për rregullimin e mangësive, në veçanti nga aspekti i ekipimit kadrovik, kushteve materiale dhe buxheti më i madh për njësitë e specializuara në gjykatë dhe në prokurorinë publike për ndjekjen e korrupsionit në nivel të lartë. Edhe një sfidë në menaxhimin me procedurat, përpos problemeve të përgjithshme paraprake të përshkruara me përputhjen e gjykatësve në më shumë lëndë, është edhe përputhja e më shumë të akuzuarve por edhe më tepër mbrojtësve në disa nga lëndët e PSP-së. Faktorëve të lartpërmendur për prolongimin e procedurave u ndërlidhen faktorë të tjerë, të cilët tërësisht janë në kompetencë të plotë të gjykatës, sikurse këshilli gjyqësor jo i plotë, ose mungesa e gjykatësit individual, ndryshimi i anëtarëve të këshillit gjyqësor, mos pasja e kushteve teknike ose hapësinore për punë, caktimi i seancës gjyqësore para kryerjes së ekspertizës gjyqësore që duhet të realizohet në seancën gjyqësore etj.

Rekomandimet të cilat rezultojnë nga kjo analizë janë:


- Sigurimi i numrit përkatës të gjykatësve në pajtim me sistematizimin, me qëllim sigurimin e punës së pa penguar dhe optimale të gjykatës;
- Shpërndarja e barabartë e lëndëve, me qëllim shfrytëzimin optimal të burimeve njerëzore me të cilat disponon gjykata, që do të kishte rezultuar me mbajtjen efikase dhe ekonomike të procedurave;
- Avancimi i Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit me burime njerëzore dhe kuadër për prokurorinë publike, ndërsa para së gjithash edhe me mbështetje financiare përkatëse nga buxheti;
- Ndërmarrja e rolit më aktiv të gjykatës, gjatë menaxhimit të seancave gjyqësore dhe koordinimin me të gjithë pjesëmarrësit në procedurat në mënyrë që të evitohen prolongimet e pa nevojshme të procedurave.

ANEKS I


TALIR




TNT




TANK (procedura është ndarë)




TOPLIK




TENK




TITANIK




TENDERË



TREQIND



TITANIK



TRANSPORTER

